Pershendetje

Nisur nga kerkesa te diteve te fundit, lidhur me faktin nese personi fizik tatimpagues, duhet te dorezoje deklarate individuale apo jo, po trajtojme mendimin tone duke pritur me respekt, mendime te ndryshme.

1.Personat fizik tatimpagues te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin (nen 8 milion leke xhiro) **nuk kane detyrim ligjor per te plotesuar deklaraten individuale**, pasi te ardhurat e realizuara, nuk konsiderohen si te ardhura personale te individit. Pika 2.3.9.paragrafi i dyte i UMF Nr.5 dt.30.01.2006 i ndryshuar.

2.Personat fizik tatimpagues te tatimit mbi fitimin (mbi 8 milion leke xhiro) **nuk kane detyrim ligjor per te plotesuar deklaraten individuale**, pasi te ardhurat e realizuara nuk konsiderohen si te ardhura personale te individit. Pika 2.3.3 dhe 2.3.9 paragrafi i dyte i UMF Nr.5 dt.30.01.2006.

3.Per sa me siper, baza ligjore eshte ne montimin ligjor te meposhtem.

UDHEZIM Nr.5, datë 30.01.2006
PËR TATIMIN MBI TE ARDHURAT

2. TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE
2.3. TË ARDHURAT E TATUESHME

Në zbatim të Nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:

…..

2.3.3 **Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut** apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit 1. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividentit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike **nuk përfshihet fitimi neto** (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) **i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.**(Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, dt. 23.05.2014. Botuar në Fl .Z Nr. 80, dt. 4 qershor 2014).

…….

2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g). Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime,

shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme te biznesit.

Nuk përfshihet në pikën "g" të nenit 8 të ligjit as fitimi neto i personave fizikë tregtarë, **pavarësisht nëse ky i fundit i nënshtrohet tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.** Të ardhurat e personit fizik tregtar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar tatohen vetëm sipas kreut III "Tatimi mbi fitimin" (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit. Personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi (i regjistruar si tregtar), ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare dhe ortakëve të saj individë **dhe rrjedhimisht fitimi neto i personit fizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhur personale e individit,** subjekt i pikës "g" të nenit 8 të ligjit. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, dt. 23.05.2014. Botuar në Fl .Z Nr. 80, dt. 4 qershor 2014).